



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 02.05.2017]

Për: Bashkimin e perkohshem te shoqerive “Kupa” shpk (35%), “Ndregjoni” shpk (40%) dhe “Kthella” shpk (25%).

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Sistemim asfaltim i rrugës Kastriot - Arras”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Sistemim asfaltim i rrugës Kastriot - Arras”**.

Kohëzgjatja: brënda 10 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: **270.144.235 (dyqind e shtatedhjetë milion e njëqind e dyzet e kater mijë e dyqind e tridhjetë e pese) Lekë pa TVSH.**

Fondi i akorduar per vitin 2017 eshte 166.666.667 leke pa tvsh. Pjesa e mbetur eshte parashikuar per vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 27.02.2017.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	OPERATORI EKONOMIK	VLERA E OFERTES PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	ALB-BUILDING	150,872,214
2	ALBAVIA	184,079,497
3	ALBA KONSTRUKSION	186,034,986
4	CURRI	186,505,301
5	HASTOÇI	203,227,927
6	KUPA	220,976,259
7	S I R E T A 2F	222,222,222
8	ULEZA NDERTIMI	233,751,592
9	ALB LEAA INTERNATIONAL	253,191,420
10	ALKO-IMPEX General Construcion	254,517,695
11	SELAMI	258,411,509
12	AFRIMI	NUK KA PARAQITUR OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Albavia” shpk (90%), dhe “Karl Gega Konstruksion” shpk (10%) per arsye se:

Shoqeria “Albavia” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier mjedisi, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit. Ka paraqitur dokumentacion per nje specialist qe ka mbaruar studimet per kimi industriale dhe si i tille nuk mund te zoteroje kualifikimet e inxhinierit te mjedisit.

Shoqeria “Karl Gega Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier mjedisi, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit. Ka paraqitur dokumentacion per nje specialist qe ka mbaruar studimet per kimi industriale dhe si i tille nuk mund te zoteroje kualifikimet e inxhinierit te mjedisit.

Shoqeria “Karl Gega Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier gjeolog, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit. Nderkohe kjo shoqeri ka marre persiper punimet per ndertimin e ures, dhe per kete pune inxhinieri gjeolog eshte i domosdoshem.

Shoqeria “Karl Gega Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me pikat e nevojshme te licenses, pasi nuk disponon piken NS 10 te kerkuar ne kerkesat per kualifikim dhe nderkohe ka marre persiper punimet per ndertimin e ures, per te cilat kjo pike eshte e domosdoshme.

Shoqeria “Karl Gega Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per kete qellim.

Shoqeria “Karl Gega Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.3.9 per kualifikim lidhur me disponimin e certifikatave ISO, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per kete qellim.

2. Te skualifikoje shoqerine “Curri” shpk per arsye se:

Nga zyra e protokollit Komisionit te Vleresimit te Ofertave ju vu ne dispozicion shkresa me nr 3/3 Prot, date 04.04.2017 derguar nga shoqeria “Curri” shpk, me objekt: “Njoftim terheqje nga Procedurat e Prokurimit elektronik te zhvilluara nga FSHZH”, me ane te se ciles kjo shoqeri deklaroi se terhiqet nga oferta per arsye se ka angazhuar stafin dhe mjetet ne nje objekt tjetër. Komisioni vendosi ta skualifikoje kete shoqeri per arsye se aktualisht nuk ploteson kerkesat per kualifikim lidhur me angazhimin e stafit dhe te mjeteve.

3. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Hastoci” shpk (50%), dhe “Al Asfalt” shpk (50%) per arsye se:

Shoqeria “Hastoci” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve te meposhtem:

- “Ndertim KUZ fshati Mashan” me vlere 19.748.706 leke me tvsh. Ky objekt nuk mund te konsiderohet si objekt i ngjashem pasi kanalizimet e ujrave te zeza nuk kane asgje te perbashket me punimet rrugore.
- “Sistemimi i shtratit te lumit Drino” me vlere 54.858.648 leke me tvsh. Ky objekt nuk mund te konsiderohet si objekt i ngjashem pasi punimet per sistemimin e shtratit te lumit nuk kane asgje te perbashket me punimet rrugore.
- “Mbrotjtje lumore lumi Drino” me vlere 53.128.915 leke me tvsh. Ky objekt nuk mund te konsiderohet si objekt i ngjashem pasi punimet per mbrotjtjen lumore nuk kane asgje te perbashket me punimet rrugore.
- “Asfaltim i rugeve te fshatit Gjokaj” me vlere 29.226.053 leke me tvsh ose 24.355.044 leke pa tvsh. Kjo pune konsiderohet si pune e ngjashme.
- “Rikonstruksion i rruges autostrade – fshati Bulo” me vlere 60.356.436 leke me tvsh ose 50.297.030 leke pa tvsh. Kjo pune konsiderohet si pune e ngjashme.
- “Rehabilitim i rrjetit ujites te tokave te Shushices” me vlere 121.618 euro pa tvsh. Ky objekt nuk mund te konsiderohet si objekt i ngjashem pasi punimet per rrjetat ujites nuk kane asgje te perbashket me punimet rrugore.
- “Rehabilitim i qendres se qytetit Librazhd” me vlere 54.245.436 leke me tvsh ose 45.204.530 leke pa tvsh. Kjo pune konsiderohet si pune e ngjashme.

- “Sistemim asfaltim rruga Lish - Shelli” me vlere 66.303.511 leke me tvsh ose 55.252.926 leke pa tvsh. Kjo pune konsiderohet si pune e ngjashme.

Vlera e plote e puneve te ngjashme eshte 175.109.530 leke pa tvsh ndersa vlera e punes me te madhe te ngjashme eshte 55.252.926 leke pa tvsh. Ne kete menyre nuk ploteson kerkesen per kualifikim pasi duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 67.536.058 leke pa tvsh ose te shume puneve me vlere 270.144.235 leke pa tvsh.

4. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Kupa” shpk (35%), “Ndregjoni” shpk (40%) dhe “Kthella” shpk (25%) per arsye se:

Shoqeria “Kthella” shpk nuk ploteson kerkesen lidhur me plotesimin e detyrimeve ndaj OSHEE pasi nuk ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

5. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Sireta 2F” shpk (42.56%), “Everest” shpk (40.53%) dhe “Artyka II” shpk (16.91%) per arsye se:

Shoqeria “Sireta 2F” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Bashkine Maliq nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

6. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Uleza Ndertim” shpk (85.54%), dhe “Almo Konstruksion” shpk (15.46%) per arsye se:

Shoqeria “Uleza Ndertim” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka te punesuar nje inxhinier ndertimi me profilin transport, sic eshte kerkuar ne dokumentet e tenderit, ndonese ka marre persiper te kryeje 85,54% te punimeve. Kjo shoqeri ka paraqitur dokumentet e ing Luan R. i cili eshte diplomuar ne vitin 1974 si inxhinier ndertimi ne profilin ndertime industriale, civile, ura. Shoqeria “Uleza Ndertim” shpk, me nje deklarate te ngarkuar ne sistem, pretendon se ing Luan R. eshte njekohesisht edhe inxhinier ndertimi me profil transport, pasi ne kohen qe ai ka mbaruar studimet profili transport ishte i perfshire. Kjo deklarate eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe shoqeria duhet te kishte punesuar per kete qellim nje inxhinier ndertimi me profilin transport, si shume shoqeri te tjera ofertuese.

Shoqeria “Uleza Ndertim” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Puke, Mirdite dhe Kurbin nga viti 2015 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Ne kete menyre edhe deklarimi per shlyerjen e te gjitha detyrimeve te taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2014 – 2015 dhe 2016 rezulton i reme.

7. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Alb Leaa International” shpk (76%), dhe “Euraldi” shpk (24%) per arsye se:

Shoqeria “Alb Leaa” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e disa objekteve por vlera e plote e puneve te ngjashme eshte 385.537.790 leke pa tvsh ndersa vlera e punes me te madhe te ngjashme eshte 71.152.098 leke pa

tvsh. Ne kete menyre nuk ploteson kerkesen per kualifikim pasi duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 135.072.117 leke pa tvsh ose te shume puneve me vlere 410.619.237 leke pa tvsh.

Shoqeria "Euraldi" shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e disa objekteve por vlere e plote e puneve te ngjashme eshte 47.765.520 leke pa tvsh ndersa vlere e punes me te madhe te ngjashme eshte 47.765.520 leke pa tvsh. Ne kete menyre nuk ploteson kerkesen per kualifikim pasi duhet te paraqiste dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 68.834.616 leke pa tvsh ose te shume puneve me vlere 129.669.233 leke pa tvsh. Puna me objekt "Ndertim i Hidrocentralit Ternove" me vlere 171.231.340 leke me tvsh nuk merret ne konsiderate per arsye se kontrata dhe formulari jane ne emer te subjektit "Teodori" ndersa faturat tatimore jane leshuar nga subjekti "Ar-Ba 06" shpk.

Shoqeria "Euraldi" shpk nuk ploteson piken 2.3.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me stafin pasi ka te punesuar vetem nje ing hidroteknik dhe nje ing gjeodet. Me kete staf nuk mund te kryeje punet qe ka marre persiper ne marreveshjen e bashkepunimit.

8. Te skualifikoje shoqerine "Alko Impex General Construcion" shpk per arsye se:

Shoqeria "Alko Impex" shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Librazhd, Devoll, Koplik dhe Kavaje nga viti 2015 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

9. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive "Selami" shpk (72%), dhe "2T" shpk (28%) per arsye se:

Shoqeria "Selami" shpk nuk ploteson piken 2.2.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me xhiron e tre viteve te fundit pasi nuk ka paraqitur te dhena lidhur me xhiron e vitit 2016. Ne kete menyre, duke e konsideruar xhiron e vitit 2016 te barabarte me zero, xhiro mesatare e tre viteve te fundit eshte 171.454.174 leke, nga 194.503.849 leke qe duhet te ishte per te permbushur kushtin, bazuar ne perqindjen e punes qe ka marre persiper.

Shoqeria "Selami" nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e nje objekti me vlere totale 787.500 euro pa tvsh ose rreth 110.000.000 leke nga 135.072.117 leke qe duhet te ishte per te permbushur kushtin, bazuar ne perqindjen e punes qe ka marre persiper, si shoqeria me perqindjen me te madhe te puneve.

10. Te skualifikoje shoqerine "Afrimi" shpk e cila nuk ka paraqitur oferte

Te konsideroje te kualifikuara shoqerite e meposhtme te cilat plotesojne kerkesat per kualifikim.

1. "Alb Building" shpk
2. "Alba Konstruksion" shpk

Komisioni kontrollloi per gabime aritmetike dhe konstatoi se nuk ka gabime.

Komisioni kontrolloi per oferta anomalisht te uleta dhe konstatoi se ofertat e shoqerive “Alb Building” shpk dhe “Alba Konstruksion” shpk jane anomalisht e uleta. Komisioni vendosi te njoftoje shoqerite qe te paraqesin argumentimet per ofertat anomalisht te uleta.

Komisioni vendosi te njoftoje shoqerite duke ju dorezuar edhe nje kopje shkresore per te paraqitur argumentimet per oferten anomalisht te ulet brenda daten 7.04.2017, ora 10.00.

Ne daten 07 Prill 2017, ora 12.00, komisioni u mblodh në lidhje me shqyrtimin e argumentimeve per ofertat anomalisht te uleta.

Shoqeria “Alb Building” shpk dhe shoqeria “Alba Konstruksion” shpk nuk kane paraqitur asnje argumentim per oferten anomalisht te ulet te paraqitur ne tender.

Komisioni me unanimitet vendosi te skualifikoje keto shoqeri dhe, ne perfundim, te skualifikoje te gjitha shoqerite nga tenderi.

Ne daten 14.04.2017 paraqiti ankim shoqeria “Kupa” shpk. Ankimit ju dha pergjigje ne daten 18.04.2017 duke e pranuar ate.

Ne daten 18.04.2017 Komisioni i Vleresimit te Ofertave beri rivleresimin e procedures duke kualifikuar bashkimin e perkohshem te shoqerive “Kupa” shpk (35%), “Ndregjoni” shpk (40%) dhe “Kthella” shpk (25%).

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e perkohshem te shoqerive “Kupa” shpk (35%), “Ndregjoni” shpk (40%) dhe “Kthella” shpk (25%) se oferta e paraqitur, me vlerë **220,976,259 (dyqind e njezet milion e nenteqind e shtatedhjete e gjashte mije e dyqind e pesedhjete e nente)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **10.11.2016**.

Ne daten 18.04.2017 paraqiti ankim shoqeria “Selami” shpk. Ankimit ju dha pergjigje ne daten 18.04.2017 duke e refuzuar ate.

Ankesa te tjera nuk ka patur.

